

Ta bëjmë Kosovën të gjelbër përsëri:

**Ambientalizmi si mjet i
edukimit qytetar**

NGA
FRANCESCO
TRUPIA &
GENTIOLA
MADHI



Ta bëjmë Kosovën të gjelbër përsëri:

**Ambientalizmi si mjet i
edukimit qytetar**

Titulli:

Ta bëjmë Kosovën të gjelbër

përsëri:

Ambientalizmi si mjet i edukimit
qytetar

Autor:


Francesco Trupia
Gentiola Madhi

Publikuar nga:

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri
të Hapur

Prishtinë,
2022

Ky botim u realizua me përkrahjen
e Fondacionit të Kosovës për
Shoqëri të Hapur, KFOS. Përmbytja
e këtij botimi është përgjegjësi e
autorit dhe në asnjë mënyrë nuk
mund të konsiderohet si qëndrim i
Fondacioneve për Shoqëri të Hapur,
OSF, apo KFOS-it.



Ta bëjmë Kosovën të gjelbër përsëri:
Ambientalizmi si mjet i edukimit qytetar

1

f.9

Hyrje

2

f.13

Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë: Një marrëdhënie e brendshme e ndërlikuar

3

f.17

Një analizë e kompleksitetit të sistemit

4

f.29

Drejt një sistem të gjelbër të virtytshëm dhe gjithëpërfshirës

f.32

Konkluzionet dhe rekomandimet

f.34

Lista e intervistave

f.35

Referencat

Lista e shkurtesave

OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
ERAC	Koalicioni për të Drejta të Barabarta për të Gjithë
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
KGR	Kosovo Glass Recycling
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
SEREC	Ndërmarrje Sociale dhe Riciklim
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim

Lista e figurave

Figura 1: Ta mbajmë Prishtinën të pastër, mars 2022.....	7
Figura 2: Një qasje vizuale ndaj kompleksitetit të sistemit aktual.....	9
Figura 3: Një model i trefishtë treguesish në lidhje me çështjet aktuale të (keq)menaxhimit të mbetjeve	11
Figura 4: Vendi i ndërtimit në lagjen Arbëri në Prishtinë, Mars 2022.....	12
Figura 5: Një qasje vizuale ndaj tre komponentëve strukturorë që kontribuojnë në ndryshime pozitive dhe qëndrueshmëri në të ardhmen në Kosovë.....	21

Mirënjohje

Autorët i dedikojnë një falënderim të veçantë të gjithë të intervistuarve, të cilët vullnetarisht kanë vendosur të marrin pjesë në intervistat online dhe të drejtpërdrejta duke i ndarë pikëpamjet personale, ekspertizën dhe përvojat e tyre të përditshme.

1 Hyrje

Që kur Kosova e shpalli pavarësinë, degradimi i mjedisit është kthyer në një bast të rëndë për pothuaj të gjitha qeveritë pasuese. Pavarësisht angazhimeve zyrtare të autoriteteve për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, duket se Kosova tani i detyrohet fatit të saj prometean¹.

Në përgjithësi, përafrimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian dhe zbatimi efektiv i tij në terren mbetet sfidë për t'u kuptuar nga publiku i gjerë. Çështja e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë paraqet një sfidë të përhershme jo vetëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e ekosistemit, por, para së gjithash, edhe për shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve. Në veçanti, menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale është një çështje e ndjeshme, pasi mbeturinat e pakëndshme të hedhura në rrugë ose qeset plastike të shpërndara në brigjet e lumenjve dhe liqeneve shihen nga të gjithë dhe paraqesin vetëm majën e një ajsbergu

që po shpër-then. Sasia e mbeturinave komunale të prodhuara nga amvisëritë ndjek një trend pozitiv në rritje. Vonesat e vazhdueshme të ndërhyrjes, mungesa e përgjegjësisë politike, keqpërdorimet e shumëfishta dhe mundësitë e humbura për investime në infrastrukturë dhe shkathtësi kanë çuar në dështim të sistemit aktual. Edhe pse korniza strategjike e vendit shpesh herë e ka pranuar pamjaftueshmërinë e sistemit për menaxhimin e mbeturinave gjatë viteve, pak përparim është bërë deri më sot.

Megjithatë, një numër i madh i organizatave të shoqërisë civile (OSHC) po tregojnë qasje qytetare mjaft aktive, spontane dhe konstruktive në trajtimin e çështjeve mjedisore. Shumë nisma të rinjve dhe aktivistëve vendorë e konsiderojnë ekologjinë dhe ekologjizmin të nevojshme për t'u trajtuar me veprime të menjëhershme. Të përhapur në tërë vendin gjatë dy viteve të fundit, aktivistët e gjelbër dhe praktikantët ekologjike kanë mbetur disi të pavërejtura, të fragmentuara

¹ Luan Shllaku, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, Ligjëratë me temë "Tranzicioni i Energjisë – Sfidat për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor", Hapësira e Veprimit të Gjelbër, Prishtinë, 12 mars 2022



Çështja e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë paraqet një sfidë të përhershme jo vetëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e ekosistemit, por, para së gjithash, edhe për shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve. Në veçanti, menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale është një çështje e ndjeshme, pasi mbeturinat e pakëndshme të hedhura në rrugë ose qeset plastike të shpërndara në brigjet e lumenjve dhe liqeneve shihen nga të gjithë dhe paraqesin vetëm majën e një ajsbergu që po shpërthen. Sasia e mbeturinave komunale të prodhuara nga amvisëritë ndjek një trend pozitiv në rritje. Vonesat e vazhdueshme të ndërhyrjes, mungesa e përgjegjësisë politike, keqpërdorimet e shumëfishta dhe mundësitë e humbura për investime në infrastrukturë dhe shkathtësi kanë çuar në dështim të sistemit aktual.

dhe ndoshta kritike për agjendën e gjelbër të BE-së dhe sjelljen e elitave politike vendore. Ambientalistët dhe të rinjtë e Kosovës parashikojnë rivendosjen dhe krijimin e marrëdhënieve të reja midis komuniteteve lokale, dhe midis njerëzve e natyrës në të gjitha aspektet e jetës së tyre të përditshme.

Ka pak dyshim se arsimit i pajis shoqëritë dhe komunitetet lokale me njohuri dhe praktika të mira për t'i trajtuar çështjet mjedisore në mënyrën e duhur. Kur krahasohen, arsimit dhe ambientalizmi përbëjnë një tandem që shpalos një sërë çështjesh, si sjellja e përditshme e qytetarëve ndaj zonave publike dhe të mbrojtura, fushatat e pasuksesshme ndërgjegjësuese të iniciuara nga institucionet në të gjitha nivelet, distanca ndërmjet pritshmërive për detyrat e paraqitura dhe të papërbushura të përfaqësuesve, dhe një mosbesim i përhapur ndaj institucioneve.² Brenda sistemit të arsimit publik e më gjerë, ekziston nevoja për të gjetur një hapësirë

të mësimdhënies dhe mësimnxënies për formimin e përgjegjësisë së qëndrueshme personale e kolektive ndaj mjedisit.

Në këtë kontekst, ky dokument i politikave e shqyrton lidhjen midis çështjeve të mbrojtjes së mjedisit dhe praktikave arsimore në Kosovë. Duke pasur parasysh kompleksitetin e sfidave mjedisore në fjalë, ne e zvogëlojmë analizën duke u përqendruar pikërisht tek sistemi për menaxhimin e mbeturinave të Kosovës. Më saktësisht, ky hulumtim e shqyrton mbivendosjen e interesave të OSHC-ve dhe aktivizmit qytetar për menaxhimin e mbeturinave në vend, duke u përqendruar në aspektet tashmë ekzistuese negative dhe pozitive të çështjes në fjalë, dhe duke i vlerësuar alternativat e reja e të mundshme që burojnë nga nismat bazë. Prandaj, ambientalizmi konsiderohet si bazë për mirëqenien e komuniteteve lokale dhe të gjithë sektorit të arsimit, nga programet joformale arsimore deri tek ato formale, nga shkollat dhe universitetet deri te pjesëmarrja spontane e qytetarëve.

2 Intervistë me Urim Xhavarinën, Let's Do it Peja, Prishtinë, 15 mars 2022.

Ky dokument përqendrohet në atë se si autoritetet e Kosovës i mbështesin nismat arsimore jashtëshkollore për t'a lavdëruar ambientalizmin si mjet të aktivizmit qytetar. Përveç kësaj, ai vlerëson se si brezat e rinj të aktivistëve, praktikuesve dhe qytetarëve të zakonshëm angazhohen, i përmirësojnë dhe i ushqejnë praktikatat e përgjegjësive qytetare ndaj ekosistemit në Kosovë.

Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare dhe studimeve *ad hoc*, ky hulumtim bazohet në një qasje të orientuar në intervista. Në fakt, një sërë intervistash janë zhvilluar online me aktivistë, praktikues dhe ekspertë gjatë shkurtit dhe marsit 2022. Gjithashtu, një sërë intervistash të tjera janë zhvilluar gjatë punës në terren në Prishtinë midis 13-18 marsit 2022. Zgjedhja për t'a hulumtuar lidhjen midis edukimit dhe aktivizmit të gjelbër nga një perspektivë nga poshtë-lartë nuk jepet vetëm nga synimi për të nxjerrë në pah çështjet e shumë debatuar në nivelin bazë, por synon gjithashtu të kontribuojë në identifikimin e alternativave të reja. Të dy perspektivat kontribuojnë në një kuptim më të mirë të skenarit të ndërlikuar për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë, dobësive sistematike dhe boshllëqeve të përditshme, si dhe dilemës së institucioneve vendore përballë aktiviteteve aktuale dhe nismave spontane kundër krizës ekologjike.

Ky dokument është i ndarë në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë ofron një pasqyrë të strategjive të politikave dhe dështimeve të sistemit për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë. Në pjesën e dytë autorët identifikojnë rolin e arsimit në të gjitha nivelet dhe aktivizmin e gjelbër si një tandem vendimtar për të analizuar më tej të

dhënat e mbledhura, si dhe njohuritë nga ekspertët, ambientalistët dhe edukatorët. Pjesa e tretë identifikon një sistem të gjelbër të virtutshëm dhe gjithëpërfshirës, të organizuar rreth promovimit dhe zhvillimit të ekonomisë qarkore. Ky model i trefishtë ofron një alternativë për t'a rishikuar qëndrueshmërinë mjedisore në Kosovë, një hapësirë më të madhe të bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve, autoriteteve dhe grupeve të ekspertëve, dhe një udhërrëfyes të ri për sektorët e arsimit për të ardhmen e brezave të rinj. Duke i shtrirë kufijtë tradicionalë të edukimit dhe aktivizmit të gjelbër, ky dokument i politikave përfundon me një sërë rekomandimesh për nismat edukative për mbrojtjen e mjedisit, përveç rritjes së ndërgjegjësimit dhe promovimit të aktivizmit bazë si mjet për edukimin qytetar.

Ky dokument tregon se si aktivizmi qytetar dhe edukimi i gjelbër janë dy fytyra të së njëjtës monedhë. Ata të dy kontribuojnë në mbrojtjen e së ardhmes së ekosistemit në Kosovë dhe e parashikojnë demokracinë e saj përmes alternativave tashmë të dukshme midis brezave të rinj.

Duke u përqendruar tek menaxhimi i mbeturinave, legjislacioni aktual i Kosovës është pjesërisht i harmonizuar me direktivat evropiane, si Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore, Direktiva Kornizë e Mbeturinave etj. Parimet 'ndotësi pagan' dhe 'përgjegjësia e prodhuesit' përmenden fjalë për fjalë në kornizën strategjike, por deri më tani nuk janë zbatuar në praktikë.



Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë: Një marrëdhënie e brendshme e ndërlikuar

Niveli i përgatitjes së Kosovës për mjedisin dhe ndryshimet klimatike tani për tani vlerësohet si i pakënaqshëm, dhe veçanërisht sistemi për menaxhimin e mbeturinave konsiderohet i paqëndrueshëm (Komisioni Evropian 2021: 100-101). Me kalimin e kohës, shumë mundësi nuk janë marrë aspak parasysh për t'a mbyllur hendekun me politikat dhe praktikatat e pritshme eko-miqësore. Komisioni Evropian vazhdimisht u ka bërë thirrje autoriteteve kombëtare për t'a intensifikuar angazhimin politik përkatës në adresimin e rekomandimeve në pritje prej kohësh për situatën në vend, bashkë me sigurimin e koherencës ndërmjet angazhimit të vendit ndaj qëllimeve të Agjendës së Gjelbër dhe kornizës politike dhe ligjore në fuqi (Komisioni Evropian 2021: 100).

Duke u përqendruar tek menaxhimi i mbeturinave, legjislativi aktual i

Kosovës është pjesërisht i harmonizuar me direktivat evropiane, si Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore, Direktiva Kornizë e Mbeturinave etj. Parimet 'ndotësi paguan' dhe 'përgjegjësia e prodhuesit' përmenden fjalë për fjalë në kornizën strategjike, por deri më tani nuk janë zbatuar në praktikë. Analiza krahasuese të katër strategjive kryesore kombëtare³ që merren pjesërisht ose tërësisht me menaxhimin e mbeturinave, nga autorët tregojnë se sfidat e këtij sektori në Kosovë vazhdojnë të paktën që nga viti 2013. Sistemi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta tani për tani mbetet i paqëndrueshëm për shkak të **mungesës së kapaciteteve** për grumbullimin e mbeturinave në të gjitha vendbanimet, mungesës së organizimit dhe **sistemit të klasifikimit** për ndarjen e mbeturinave, mungesës së **makinerive dhe pajisjeve për grumbullimin e mbeturinave**, **mungesës së investimeve** në deponitë sanitare, krijimit të **deponive ilegale**, bashkë

³ Strategjitë e konsultuara janë me sa vijon: Strategjia e Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2013-2020; Strategjia e Kosovës për mjedisin 2013-2022; Strategjia kombëtare e Kosovës për zhvillim 2016-2021; Strategjia e Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2022-2030.



me nivelin e ulët të rikthimit të kostos për shërbime. Moszbatimi i legjislationit në fuqi, boshllëqet ekzistuese ligjore dhe përcaktimi i paqartë i delegimit të detyrave dhe përgjegjësive kanë krijuar hapësirë shtesë për abuzime dhe keqpërdorime. Nuk janë më pak të rëndësishme as **njohuria, ndërgjegjësimi dhe edukimi i pamjaftueshëm** i punonjësve të sektorit dhe publikut të gjerë për çështjet e mbrojtjes së mjedisit.

Një faktor tjetër vendimtar është kapaciteti i kufizuar dhe, deri në njëfarë mase, vullneti politik për të krijuar **mekanizma funksionalë bashkëpunimi ndërinstytucional** që mundësojnë trajtimin e çështjes në nivele të ndryshme. Pavarësisht natyrës së decentralizuar për menaxhimin e mbeturinave, shumica e deponive përballen me sfida. Ato kërkojnë një ndërhyrje nga autoritetet qendrore – përkatësisht Ministria e Mjedisit,

Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe agjencitë përkatëse – të cilat kanë dështuar deri më tani në arritjen e mbrojtjes së mjedisit, pasi ende nuk janë përfshirë në prioritetet e tyre kryesore. Për shembull, në raportin e saj të fundit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA) theksoi se ministria ende nuk i kishte hartuar dokumentet e politikave dhe procedurat e pritshme për kategorizimin dhe menaxhimin e të gjitha llojeve të mbeturinave (Republika e Kosovës 2021), si një hap i parë drejt procesit të riciklimit. Nga ana tjetër, autoritetet komunale, të përfshira drejtpërdrejtë, luftojnë për të vendosur procedura dhe praktika funksionale, përfshirë kontrollin e shpeshtë të sistemit për grumbullimin e mbeturinave në vend. Kompanitë e kontraktuara nga komunat gjithashtu pasqyrojnë paaftësinë e zinxhirit menaxhues për të ofruar shërbime esenciale për menaxhimin e mbeturinave. Tani për

FIGURA 1

Ta mbajmë Prishtinën të pastër, mars 2022.



Sistemi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta tani për tani mbetet i paqëndrueshëm për shkak të mungesës së kapaciteteve për grumbullimin e mbeturinave në të gjitha vendbanimet, mungesës së organizimit dhe sistemit të klasifikimit për ndarjen e mbeturinave, mungesës së makinerive dhe pajisjeve për grumbullimin e mbeturinave, mungesës së investimeve në deponitë sanitare, krijimit të deponive ilegale, bashkë me nivelin e ulët të rikthimit të kostos për shërbime.

tani, nuk ka stimuj për rritjen e numrit të aktorëve privatë në këtë sektor dhe, si rrjedhojë, as për nxitjen e konkurrencës dhe zgjerimin e tregut.

Mungesa e të dhënave dhe procedurave të standardizuara të raportimit nga të gjithë aktorët vazhdon të jetë një sfidë tjetër, dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ende nuk është në gjendje të ofrojë një gamë të plotë të informatave të krahasueshme për gjendjen e punëve në nivel të vendit. Sipas raportit të saj të fundit, në vitin 2020, mbulimi i shërbimit për grumbullimin e mbeturinave për amvisëri ishte 85,3%, që shënoi një rritje prej 7% në krahasim me vitin paraprak (AMMK 2022: 13). Në të njëjtën periudhë, ky shërbim arriti në 53,7% për sektorin e biznesit dhe në 84,8% për institucionet publike. Pamundësia për t'a mbuluar tërësisht shërbimin për grumbullimin e mbeturinave, të paktën për institucionet publike, mbetet zhgënjyese. Megjithatë, sukcesi i raportuar më lart nuk përmbush objektivin zyrtar të mbulimit 100% të grumbullimit të mbeturinave deri

në vitin 2020, siç është planifikuar nga Strategjia për menaxhimin e mbeturinave 2013-2020. Sasia e mbeturinave të ngurta komunale të gjeneruara për vitin raportues 2020 arriti në 480.648,62 tonë, nga të cilat 92,8% u depozituan në deponitë sanitare, dhe pjesa tjetër në deponitë ilegale dhe/ose pjesërisht ricikloheshin nga sektori joformal (AMMK 2022: 12). Është me rëndësi të theksohet se shifrat e raportuara përkrijnë vetëm me sasitë e mbledhura dhe nuk ka vlerësime zyrtare të pjesës së pambledhur të mbeturinave të ngurta komunale të gjeneruara.

Kushtet teknike të deponive sanitare në Kosovë po përkeqësohen dukshëm dhe koha po kalon sepse autoritetet mbeten indiferente ndaj nisjes së investimeve të menjëhershme për rehabilitim. Shtatë deponitë sanitare që operojnë në nivel rajonal/komunal në Kosovë nuk ende janë të çertifikuara dhe nuk funksionojnë plotësisht në përputhje me të gjitha standardet mjedisore në fuqi (SKZH, 2016: 51). Edhe pse agjencia shtetërore përgjegjëse në Kosovë i konsideron zonat e përcaktuara si 'deponi sanitare', një raport i fundit i Agjencisë Evropiane të Mjedisit thotë se këto nuk funksionojnë plotësisht sipas kushteve të përcaktuara në Direktivën e BE-së për deponitë (AEM 2021: 5), prandaj statusi i tyre 'sanitar' është i diskutueshëm. Ndërkohë, **deponitë ilegale** vazhdojnë të jenë një tjetër kërcënim i rëndë për mjedisin. Shumica e mbeturinave përfundojnë në këto vende të pamenaxhuara siç duhet. Pavarësisht përpjekjeve për largimin e tyre, në 38 komunitat e Kosovës, numri i raportuar i deponive është 1.189 (AKMM 2022: 23). Këto deponi ilegale janë të ndara sipas madhësisë dhe është shqetësuese që

pothuajse gjysma e tyre (saktësisht 558) janë dukshëm të mëdha për sa i përket sipërfaqes dhe sasisë së mbeturinave të depozituara. Deri në një farë mase, numri i raportuar i deponive ilegale në vitin 2021 u ul me 300 njësi krahasuar me vitin e mëparshëm. Ndërkohë, në vitin 2019, numri ishte rritur në 2.529 njësi të deponimit ilegal, gjë që përbën rrezik serioz shëndetësor për popullatën dhe rëndon ndotjen e mjedisit (Komisioni Evropian 2020: 93).

Gjendja e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë duket, deri në një farë mase, e ngjashme me dilemën shkakore të vezës dhe pulës. Rrethi vicioz i krijuar në këtë fushë i sheh si protagonistë qytetarin/popullin, nga njëra anë, dhe sistemin në fuqi, nga ana tjetër. Deri në një farë mase, qytetarët mund të konsiderohen si kontribues të drejtpërdrejtë të degradimit të mjedisit. Megjithatë, në të njëjtën kohë, pamjaftueshmëria e sistemit aktual ndikon drejtpërdrejt në sjelljet e virtytshme të qytetarëve dhe në mungesën e pronësisë qytetare. Infrastruktura e pamjaftueshme dhe numri i konsiderueshëm i deponive ilegale e bëjnë pothuajse të pamundur ndarjen e mbeturinave në burim.

Duke kthyer vëmendjen tek sektori privat, disa faktorë dekurajues kufizojnë hyrjen e aktorëve privatë në treg, si p.sh. vakumet ligjore ekzistuese, procedurat e gjata e burokratike të licencimit, mungesa e lojës së ndershme, mungesa e zbatimit të ligjit etj. Deri tani ka nuk ka studime të fizibilitetit mbi mundësinë e të bërit biznes në këtë sektor në Kosovë. Ndërsa investimet në infrastrukturë përbëjnë fazën e parë ku duhet të përqendrohemi, krijimi i një tregu do të ishte, padyshim, i

dobishëm për mbrojtjen e mjedisit dhe për mundësi të reja për punësimin e brezave të rinj. Çështja e kostos financiare nuk është më pak e rëndësishme dhe strategjia aktuale e mjedisit 2013-2022 pranon se nuk ka kushte për aplikimin e instrumenteve ekonomike përveç buxhetit të shtetit dhe kontributeve të donatorëve. Mundësia për të miratuar skema subvencionimi për operatorët e biznesit në fushën e riciklimit mund të kontribuojë në një kthesë drejt shfaqjes së një biznesi të ri. Kjo strategji gjithashtu parashikon mundësinë e investimit në djegien e mbeturinave për prodhim të energjisë, ndonëse kjo mundësi nuk ka pasur asnjë vazhdimësi deri më tani. Në raportin e saj, ZKA-ja vlerëson se nuk ka informata në dispozicion për ecurinë e investimeve të ndërmarra më parë në fabrikat për trajtimin e mbeturinave dhe për makinerinë për ndarjen e mbeturinave në burim (Republika e Kosovës 2021), gjë që e ndërlikon fazën tjetër të planifikimit të ndërhyrjes sektoriale.

Në përgjithësi, vlerësohet se Kosova eksporton rreth 40 milionë euro materiale të ricikluara, p.sh. metal, plastikë, letër dhe qelq, në vendet fqinje si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Turqia etj. (ERAC 2019). Në nivel vendor, mbeturinat e letrës dhe të plastikës riciklohen nga disa nisma afariste, si fabrika e riciklimit Izolimi Plast apo e sapo themeluara Kosovo Recycling Glass (Kabashi 2021). Megjithatë, ka ende hapësirë të mjaftueshme për të manovruar dhe nxitur zhvillimin e tregut, si dhe mbrojtjen e ruajtjen e mjedisit.


3 Një analizë e kompleksitetit të sistemit

Kompleksiteti i sistemit të menaxhimin e mbeturinave në Kosovë mund të ilustrohet vizualisht përmes një thjerrëze trekëndore, ku secila anë përfaqësohet nga institucionet shtetërore (qendrore dhe lokale), aktorët e

shoqërisë civile dhe institucionet arsimore (shih figurën 2). Performanca dhe qëndrueshmëria e sistemit kërcënohet nga mungesa e një fluksi të vazhdueshëm të informatave, mundësia e bashkëpunimit dhe/ose veprimet e përbashkëta.

FIGURA 2

Një qasje vizuale ndaj kompleksitetit të sistemit aktual



Në sferën e edukimit të gjelbër, të tri anët e këtij trekëndëshi mund të kontribuojnë reciprokisht në arritjen e qëllimit gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Megjithatë, deri më sot, sfidat e shumta (siç u analizuan më lart) nxjerrin në pah mungesën e një lidhjeje më të thellë ndërmjet palëve dhe fragmentimin e veprimeve qytetare.

Ndryshe nga fushat e tjera të politikave, arsimiti zotëron një natyrë transversale dhe krijon hapësira për kontributin e aktorëve të shumtë. Siç ka argumentuar Komisionerja e BE-së për Inovacion, Hulimtim, Kulturë, Arsim dhe Rini, Mariya Gabriel, nuk ka dy dyshim që arsimiti mund të luajë një rol kryesor në frymëzimin e sjelljes së qëndrueshme dhe për t'u ndihmuar qytetarëve të kalojnë nga ndërgjegjësimi në veprim. Me fjalë më të thjeshta, roli i arsimit mund ta rishikojë dhe përmirësojë pjesëmarrjen qytetare duke e rritur ndërgjegjësimin për çështjet në fjalë dhe duke e rritur qëndrueshmërinë e qytetarëve në nivel lokal. Kuptohet që arsimiti në vetvete nuk duket t'i parashikojë shqetësimet e njerëzve për ndryshimet klimatike dhe ekologjinë në tërësi. Nevoja për ta zgjeruar si nocionin, ashtu edhe rolin e arsimit, ka më shumë të ngjarë t'i lehtësojë dhe mbështesë angazhimet e qëllimshme ose të kujdesshme të qytetarëve ndaj mjedisit në vend, që ta identifikojë një qëndrim pritë-shih të lidhur negativisht me mungesën e zgjidhjes së problemeve nga lart-poshtë dhe paaftësinë politike për t'i trajtuar çështjet mjedisore siç duhet.

Nga intervistat e realizuara rezultoi që shumica e ekspertëve të OSHC-ve në Kosovë e identifikojnë një model të

trefishtë të treguesve (shih figurën 3) për ta vizualizuar më mirë skenarin kompleks në lidhje me çështjet aktuale të (keq) menaxhimit të mbeturinave – domethënë, (i) **ndërgjegjësimi**; (ii) **alternativat**; dhe, (iii) **sundimi i ligjit**⁴ (të cilat do të analizohen në seksionet në vijim). Secili prej këtyre tre komponentëve përbën një tjetër “trekëndësh ideal”, lidhjet e të cilit ndërmjet këndeve të tij qëndrojnë mbi njëra-tjetrën. Një trekëndësh i tillë i ilustron jo vetëm çështjet e rëndësishme në fjalë, por edhe një sistem potencialisht të virtytshëm për Kosovën. **Treguesi i ndërgjegjësimit** ndihmon në identifikimin e *ndarjes rurale/urbane dhe të hendekut të brezave* për çështjet mjedisore. Përveç kësaj, **treguesi i alternativave** nuk mund ta anashkalojë *mungesën e bashkëpunimit* ndërmjet tërë sektorit të arsimit dhe shoqërisë civile. Nga ana tjetër, **treguesi i gjendjes së sundimit të ligjit** ndikohet nga *mosgatishmëria politike për ta përfshirë mbrojtjen e mjedisit dhe nga mungesa e zbatimit të ligjit në të gjitha nivelet*. Të tri aspektet e modelit të ilustruar tregojnë për një sërë aktorësh dhe mundësisht që mund të nxisin në mënyrë drastike një kthesë në çështjet mjedisore të Kosovës. Përkatësisht, **fushatat ndërgjegjësuese** mund t'i mbështesin praktikatat e mira që tashmë ekzistojnë në nivelin bazë dhe aktivitetet institucionale që synojnë t'i mbështesin ato. Ndërkohë, **konceptet e reja alternative** mund të shkojnë paralelisht me një **bashkëpunim më të fortë** ndërmjet shkollave, universiteteve dhe qendrave arsimore me shoqërinë civile, të afta për të ofruar njohuri të reja për mjedisin dhe shkathtësi alternative për të rinjtë dhe për zbatimin e ligjit në të gjitha nivelet.


4 Intervistë me Urim Xhavarinën, Let's Do it Peja, Prishtinë, 15 mars 2022.

2.1 Sundimi i ligjit dhe agjenda politike

Edhe pse Kosova ka një kornizë të mirë ligjore për çështjet mjedisore, mungesa e zbatimit të ligjit mbetet sfidë thelbësore dhe shkakton pakënaqësi të madhe

midis komuniteteve lokale.⁵ Përveç kësaj, përjashtimi i çështjeve mjedisore nga prioritetet kryesore të autoriteteve qeverisëse i dëmton më tej kushtet e habitatit dhe, në një farë mase, nxit mosbesimin e qytetarëve ndaj elitave politike.

FIGURA 3
Një model i trefishtë i treguesve lidhur me çështjet aktuale të (keq) menaxhimit të mbeturinave



5 Luan Shllaku, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, Ligjëratorë me temën "Tranzicioni i Energjisë – Sfidat për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor", Hapësira për Veprim të Gjellbër, Prishtinë, 12 mars 2022.



Çështjet kryesore të identifikuar në fushën e menaxhimit të mbeturinave, siç ilustrohen në figurën 3, mund të përmbliken në sa vijon: (A) **paaftësia e përgjithshme institucionale** në të gjitha nivelet. Këtu, Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës identifikon si prioritet kryesor në agjendën politike si mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës po ashtu edhe udhërrëfyesin për modelin e menaxhimit të krizave për çështjet mjedisore të Kosovës; (B) **dobësia në zbatimin e sundimit të ligjit**, e shkaktuar nga mungesa e kriterëve të duhura për zbatimin e ligjit, përafrimi me legjislacionin e BE-së etj.; (C) **sfidat financiare** që nuk u lejojnë as autoriteteve dhe as OSHC-ve të ndërmarrin veprime të duhura dhe të bashkëpunojnë midis

tyre; dhe (D) **mungesa e kapacitetit institucional** për t'i përmbushur siç duhet detyrat e parashikuara nga profili i punës.

Mungesa e zbatimit të ligjit ka çuar në ndryshime në sektorë të ndryshëm, si p.sh. zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbra, ndërtimet e pakontrolluara, si dhe urbanizimi shumë i ndotur i kryeqytetit të Kosovës⁶. Në këtë drejtim, një sasi e madhe e mbeturinave dhe e materialeve ndërtimore ndotin hapësirat përreth vendeve të ndërtimit, të cilat janë kthyer në deponi ilegale.

Ndërtimi i hidrocentraleve është një tjetër shembull i rrezikut të lartë të abuzimit dhe dëmtimit të ekosistemit natyror. Në tri vjetët e fundit, Grupi për Studime

FIGURE 4

Vendi i ndërtimi në lagjen Arbëria në Prishtinë, mars 2022.

6 Intervistë me Arta Haxhixhemajlin, Qendra për Analizë të Sigurisë dhe Parandalim, Prishtinë, 17 mars 2022.



Juridike dhe Politike dhe GAIA Kosovë kanë bashkëpunuar kundër hidrocentralit të Brezovicës, duke i mbështetur kundërshtimin e qytetarëve dhe përpjekjet proaktive për mbrojtjen e mjedisit. Kur Gjykata Supreme e Kosovës e rrëzoi vendimin e mëparshëm të Gjykatës së Apelit, me të cilin e pezullonte ndërtimin e hidrocentralit të Brezovicës dhe pranonte anulimin e kërkuar, mijëra aktivistë të rinj u shpërblyen për kundërshtimin e këtij projekti. Mobilizimi i lidhur me bazën nuk ishte akt i thjeshtë i pjesëmarrjes qytetare. Megjithatë, ai pasqyroi një gatishmëri më të gjerë të të rinjve dhe të komuniteteve lokale për të ofruar alternativa të reja për të jetuar në mënyrë të qëndrueshme dhe në lidhje me natyrën.



“Nuk kishim fare ide si ta fitonim një çështje, por ia dolëm. Pas një kohe të gjatë të bashkëpunimit dhe aksioneve të solidaritetit me banorët e Shtërpcës, ne ia dolëm”

HELENA POUČKI, GAIA KOSOVË

Një hap tjetër thelbësor në sundimin e ligjit është bërë nga organizata EcoZ, e cila po mbështet bashkëpunimin ndërmjet Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe grupeve qytetare të juristëve të karrierës së hershme në krijimin e një sistemi të strukturuar të njohurive për çështjet

mjedisore. Kjo nismë synon të sigurojë njohuri teknike për studentët e drejtësisë për vlerësimin e dëmit të ndotjes së mjedisit dhe dokumentimin e dëmeve në gjykatë.

Përkundër arritjeve të ilustruara, nisma të ngjashme qytetare në Kosovë mbeten në një fazë embrionale dhe të fragmentuara ndërmjet njëra-tjetrës. Nuk duhet të harrohet prania e sfidave strukturore, si distanca ekzistuese ndërmjet komunitetit serb dhe pjesës tjetër të Kosovës. Në shumicën e rasteve, pjesëmarrja e komunitetit serb në trajnime apo veprime të përbashkëta nuk mund të merret si e mirëqenë. Ekziston një çështje e besimit të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve, e cila i sfidon keqkuptimet dhe kontribuon në thyerjen e stigmës dhe në ndërtimin e veprimeve të gjelbra të përbashkëta⁷. Në qytetin e Pejës, për shembull, çështjet mjedisore kanë dëshmuar se i bashkojnë qytetarët vendorë nga komuniteti shqiptar dhe serb. Vendorët kanë filluar të bashkëpunojnë përtej dobësive institucionale të Kosovës. Edhe pse sistemi paralel i mbështetur nga Serbia teorikisht nuk mund të lejojë që komunat e saj me shumicë serbe të bashkëpunojnë me sistemin për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë, kryetari i Pejës ka mbështetur nismën e shqiptarëve vendorë për ta filluar bashkëpunimin me fshatrat serbe. Si rezultat, komunitetet shqiptare të Pejës dhe fshatrat serbe përreth qytetit kanë krijuar një partneritet që ka ofruar një sistem të qëndrueshëm për grumbullimin e mbeturinave dhe një ndikim në rënie në deponitë ilegale⁸. Supozoni se ky bashkëpunim bazë është dëshmuar në vërtetë se grupet rurale tregojnë një dinamikë pak më pozitive kur

ndërmarrin veprime kundër keqmenaxhimit të mbeturinave. Në atë rast, gjithashtu është e vërtetë se roli i autoriteteve qendrore në forcimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit mbetet vendimtar për një sistem gjyqësor solid.

2.2 Ndërgjegjësimi dhe alternativat bazë: nga njohuria në praktikë

Një studim i kohëve të fundit, i realizuar me nxënës të shkollave të mesme dhe disa fakultete të Universitetit të Mitrovicës, tregon për një orientim pro-ekologjik të brezave të rinj. Përveç kësaj, të rinjtë nga Kosova priren të besojnë në lidhjen e thellë ndërmjet njerëzimit dhe natyrës (Srbinovski et al, 2020:193). Po kështu, shumica e qytetarëve në moshë madhore janë të vetëdijshëm për sfidat dhe çështjet shoqërore që rrjedhin nga keqmenaxhimi i mbeturinave dhe që ndikojnë për keq në jetën e tyre. Edhe pse institucionet e Kosovës mezi flasin për çështjen e cilësisë së dobët të arsimit dhe programeve arsimore në përgjithësi, aktivitetet joformale dhe jozyrtare kryhen nga qytetarët e rëndomtë, veçanërisht nga adoleshentët.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, shumica e qytetarëve që banojnë në zonat urbane janë të mbingarkuar nga promovimi i praktikave të gjelbra.⁹ Edhe pse shumë prej tyre tashmë janë të prirur për të pasur sjellje të qëndrueshme në jetën e tyre të përditshme, gjithashtu duhet theksuar se Kosova nuk ka një sistem të mirëfilltë për klasifikimin e mbeturinave.¹⁰ Qytetarët e zakonshëm luftojnë, para së gjithash, për t'i ndarë

7 Intervistë me Valon Xhibalin, Ec Ma Ndryshe, 9 mars 2022.

8 Intervistë me Urim Xhavarinën, Let's Do it Peja, Prishtinë, 15 mars 2022.

9 Intervistë me Egzona Shalën, Youth Ecological and Security Zone-EcoZ, Prishtinë, 16 mars 2022.

10 Intervistë me Prof. Xhevat Berishën dhe Prof. Bukurije Hoxhën, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Prishtinë, 14 mars 2022.

burimet e ndryshme të mbeturinave, duke u mbështetur gabimisht ose në hedhjen e çdo lloj mbeturine në të njëjtin kontejner ose, në rastin më të keq, duke i përdorur zonat publike pranë vendbanimit të tyre si deponi.¹¹ Përkundër kësaj, një numër i madh i nismave nga poshtë-lart janë rritur dhe promovuar me kalimin e kohës. Për shembull, që nga viti 2014, grupi i ambientalistëve nga 'Let's do it Peja' ka dhuruar kontejnerë me ngjyra të ndryshme si për shkolla, ashtu edhe për ndërtesa institucionale, duke ofruar udhëzime se si të ndahen mbeturinat dhe të fillohet me praktikën e mira të menaxhimit të mbeturinave. Nisma të ngjashme janë përhapur me kalimin e kohës në tërë Kosovën me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë.

Megjithatë, është po ashtu me rëndësi të reflektohet në përmasën në të cilën përhapja e nismave të përditshme - si "fushatat e pastrimit" -, të organizuara gjatë tërë vitit nga institucione të ndryshme ose aktorë të shoqërisë civile, e përqafon një zgjidhje të qëndrueshme për mjedisin. **Në të vërtetë, është jetike gjetja e një gjuhe të përbashkët dhe koordinimi i veprimeve** ndërmjet qytetarëve, institucioneve lokale e qendrore dhe operatorëve të kontraktuar, të ngarkuar me grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave. Përveç kësaj, **monitorimi i vazhdueshëm dhe i pavarur gjithashtu mund të ushtrojë presion proaktiv** mbi aktorët në terren.¹²

Sigurimi i qëndrueshmërisë në sektorin për menaxhimin e mbeturinave është detyrë komplekse që kërkon ndërhyrje afatgjata, të cilat e anashkalojnë afatin e zakonshëm politik katërvjeçar. Nëse i referohemi kornizës së politikës së brendshme, një nga objektivat kryesore të Strategjisë së Mjedisit

ka qenë rritja e mbështetjes institucionale dhe përfundimtare në nivel vendor për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve. Përveç mundësive të pamjaftueshme financiare të alokuara deri më tani për këtë qëllim, është me rëndësi të reflektohet edhe në aspektet sociale të realizimit të fushatave edukative dhe ndërgjegjësuese për sfidat afatgjata si menaxhimi i mbeturinave. **Ekziston nevoja për t'i shumëfishuar fushatat e njëjta publike** me qëllim që të synohen audiencë të ndryshme në bazë të moshës, nivelit arsimor, zonës së banimit etj., për t'i **adresuar më mirë nevojat e ndryshme të komuniteteve dhe mirëkuptimin** në tërë vendin. Nga kjo kërkesë specifike do të përfitonin edhe komunitetet lokale, veçanërisht ato të afta për t'i trajtuar prioritetet dhe problemet e tyre në nivel lokal. Tani për tani, **fushatat ndërgjegjësuese kanë më pak gjasa ta bartin porosinë e duhur tek një audiencë më e gjerë e qytetarëve** dhe të ofrojnë informata të sakta për zonat rurale sesa ato urbane.

Nga njëra anë, pandemia, që ende po vazhdon, ka sjellë në vëmendjen e të rinjve dhe/ose të klasës së mesme çështjet mjedisore dhe efektet e tyre në shëndetin e njeriut. Nga ana tjetër, vendasit që banojnë në zonat rurale ose familjet me të ardhura të ulëta për shembull, vazhdojnë ta zhvendosin vëmendjen nga tabloja e madhe e problemeve në fjalë për shkak të nevojave të tjera më imediate. Kur u referohemi **komuniteteve rurale**, në një masë të caktuar, ata priren të ndihen të paangazhuar dhe të pamotivuar për të kontribuar në alternativat e reja që e mbështesin riciklimin, ekonominë qarkore dhe nisma të tjera të lidhura me menaxhimin e mbeturinave. Një shpjegim i mundshëm në këtë drejtim është mospërputhja ekzistuese

11 Intervistë me Martin Berishën, Kosovo Glass Recycling, Prishtinë, 17 mars 2022.

12 Intervistë me Arben Nikën, Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit, intervistë online, 7 mars 2022.

TA BËJMË KOSOVËN TË GJELBËR PËRSËRI:

ndërmjet vëmendjes së autoriteteve vendore dhe donatorëve ndaj zonave rurale kur trajtohen çështjet e menaxhimit të mbeturinave.¹³

Në të kaluarën e afërt, fokusi i ndërhyrjes lidhur me temat që kanë të bëjnë me mbeturinat ka qenë pothuajse gjithmonë në zonat urbane, veçanërisht në zonat kryesore, duke i lënë pas komunitetet rurale, qoftë për pilotim, qoftë për aktivitete edukative. Në të vërtetë, intervistat e realizuara kanë treguar se ekziston një komunitet i gjallë edhe në zonat rurale të Kosovës, i cili është i prirur t'i thellojë njohuritë dhe të zbatojë veprime që e mbrojnë tokën e tyre. Në këtë drejtim, kontakti i vazhdueshëm me tokën dhe ciklet e prodhimit kanë kontribuar në një ndërgjegjësimit të madh për rolin dhe ndikimin e natyrës në jetën e komunitetit rural.



Jemi të befasuar me të rinjtë nga zonat rurale. Shpesh na është kërkuar të mbështesim shtigje ose rrugë më të përshtatshme për çiklizëm dhe parkingje për biçikleta pasi mungesa e tyre i bën ata të udhëtojnë në këmbë ose t'i detyrojnë prindërit të sigurojnë transport. Përveç kësaj, nëse ka infrastrukturë dhe nëse ka mundësi për ta parkuar biçikletën [...], ata do ta përdorin atë. [...] Nga ana tjetër, ata e ndiejnë mungesën e aktiviteteve dhe hapësirave shumëfunktionale për socializim.”

VALON XHIBALI, EC MA NDRYSHE.

Në vend të kësaj, situata duket pak më ndryshe për **brezat e vjetër**, të cilët **luftojnë për t'i arritur paradigmat që gjithmonë ndryshojnë**, duke kërkuar një qëndrim të vazhdueshëm e të përditësuar ndaj sfidave të reja në baza ditore. Kjo çështje thellohet edhe më shumë kur merren parasysh komunitetet e shkatërruara nga lufta.



Plagët nga e kaluara nuk janë shëruar ende, dhe brezi i vjetër e ka shumë të vështirë ta mbështesë aktivizmin qytetar. [...] Por e kaluara nuk do, dhe nuk duhet, ta tregojë të ardhmen tonë”

VLERA KURBOGAJ DHE VIOLA BERISHA,
NISMA RESPEKTONI TË DREJTATONA

Kuptohet që paradigmat mjedisore po ndryshojnë shpejt dhe vazhdimisht kanë nevojë për përmirësime¹⁴, **nevoja për të gjetur mënyra të reja për ta harmonizuar lidhjen ndërmjet sjelljes së komunitetit dhe shqetësimeve mjedisore** është një nga prioritetet kryesore. Në rastin e zonave rurale, që kryesisht përbëhen nga qytetarë të moshuar, trashëgimia e luftës së Kosovës 1998-99 nuk mund ta hapë një proces të mëtejshëm të stigmatizimit kundër edukimit mjedisor. Përshtatja ndaj formave të reja të edukimit qytetar lidhur me krizën aktuale mjedisore do të kërkonte, pa dyshim, një përpjekje më të madhe. Krahasuar me brezin e pasluftës që banon në kryeqytet dhe në zona të tjera urbane, të moshuarit tashmë janë përshtatur në një shoqëri të shkatërruar nga lufta.

13 Intervistë me Afrim Berishën, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, intervistë online, 10 mars 2022.

14 Luan Shllaku, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, Ligjëratë me temën “Tranzicioni i Energjisë – Sfidat për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor”, Hapësira e veprimit të gjelbër, Prishtinë, 12 mars 2022.

OSHC-të dhe institucionet shtetërore të Kosovës duhet ta **reflekojnë, rishqyrtojnë dhe rishikojnë rolin e aktivizmit të gjelbër në një perspektivë më të gjerë** përgjatë dhe përtej brezave dhe konteksteve të ndryshme hapësinore. Me kalimin e kohës, shumica e fushatave ndërgjegjësuese synojnë kryesisht të rinjtë dhe përhapin porosi dhe praktika të mundshme të mira në zonat urbane. Të njëjtat fushata dhe projekte publike vënë në dukje tri keqkuptime kryesore të një edukimi të mundshëm të ri qytetar dhe të qëndrimeve për të gjithë qytetarët, si dhe për mjedisin dhe mbrojtjen e tij në tërë vendin.

Së pari, shumica e projekteve dhe trajnimeve të avokimit janë të orientuara drejt brezave të rinj - të cilët tashmë janë qytetarët më të zëshëm dhe më aktivë me një nivel të lartë të vetëdijesimit dhe ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore. Në të njëjtën kohë, i njëjti grup i synuar vazhdon të mbetet i padëgjuar dhe konsiderohet i pabesueshëm nga institucionet lokale, rajonale dhe kombëtare.¹⁵ Së dyti, ndërsa OSHC-të drejtojnë projekte dhe veprime në grupe urbane ndërmjet të rinjve, zonat rurale dhe komunitetet e tyre konsiderohen grupe të qytetarëve me pak njohuri për praktikën e mira dhe mjedisin se si të reduktohet konsumi i plastikës, si të riciklohen artikujt e ndryshëm dhe si të pajtohen me menaxhimin e disa mbeturinave në zonat e tyre të banimit. Në mënyrë paradoksale, ndërsa brezat e rinj nuk kanë nevojë për shumë inkurajim për t'u përfshirë në praktikën e mira drejt mjedisit dhe të ardhmes së ambientalizmit, brezat e vjetër

e kanë një nivel më të lartë të riciklimit dhe më pak qëndrime konsumatore. Në kontekstet rurale, ndarja ndërmjet sferës publike dhe private është shumë më e ngushtë se në kontekstet urbane. Aktivizmi i gjelbër dhe përpjekjet mjedisore paraqiten në mënyrë jokritike. Duke qenë të kufizuar në çfarëdo forme të kritikës së angazhimit qytetar, problemet e rënda mjedisore në Kosovë dhe në vendet e tjera fqinje shpesh nuk merren seriozisht. Së treti, çështjet shumë dimensionale të menaxhimit të mbeturinave nuk mund të përjashtojnë forma të tjera të ndotjes së ajrit dhe të ujit.

Siç kanë vënë në dukje praktikuesit dhe aktivistët e intervistuar, keqmenaxhimi i mbeturinave nuk ndikon vetëm në mjedis: ai gjithashtu ngre shqetësime të mëdha në sektorët e tjerë të shoqërisë dhe ekonomisë në zhvillim të Kosovës, si bujqësia dhe turizmi. Lidhur me këtë, OSHC-të dhe institucionet e lidhin zgjidhjen e mundshme për zgjidhjen e problemeve të menaxhimit të mbeturinave me çështjen e ndotjes dhe konsumit nga plastika. Prandaj, promovimi i nismave të gjelbra dhe i fushatave për ndërgjegjësimin e publikut i lë mënjanë çështjet e tjera brenda sistemit për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë. Ndër të tjera, konsumi dhe riciklimi i qelqit janë anashkaluar tërësisht, pavarësisht nga rëndësia e tij në tërë vendin. Që nga pavarësia, tonelata të materialit të qelqit kanë hyrë në Kosovë pa ndonjë sistem të duhur të klasifikimit dhe riciklimit të mbeturinave. Në fakt, deponitë e Kosovës janë plot me qelq pasi nuk është identifikuar apo krijuar asnjë zonë e vetme për mbeturinat e qelqit dhe riciklimin e tij të mundshëm.¹⁶

¹⁵ Intervistë me Evelin Van der Kooi, Sustainable Living Kosovo, intervistë online, 28 shkurt 2022

¹⁶ Intervistë me Martin Berishën, Kosovo Glass Recycling, Prishtinë, 17 mars 2022.

2.3 Arsimi dhe shoqëria civile: plotësimi i boshllëkut

Teorikisht, arsimi luan një rol kyç në formimin e një pikëpamjeje ekologjike të botës (Srbnovski et al 2020: 190). Është po ashtu me rëndësi të shfrytëzohet ekspertiza e OSHC-ve ndaj komuniteteve lokale me rastin e hartimit të politikave që sigurojnë përfshirje dhe politikëbërje të shëndoshë (Clingendael 2021: 6). Në Kosovë, pothuaj e gjithë sfera e edukimit të gjelbër është vendosur në qendër të sektorit të shoqërisë civile. Lidhja ndërmjet një promovimi nga poshtë-lart të praktikave të mira mjedisore dhe aktiviteteve përkatëse të advokimit në fushën e arsimit është marrë parasysh.

Sipas Strategjisë së mjedisit të Kosovës 2013-2020, janë zhvilluar planet dhe programet për edukim mjedisor në të gjitha nivelet e ndryshme të shkollave. Megjithatë, tri çështje meritojnë t'u kushtohet vëmendje: së pari, nuk është bërë një vlerësim mbi arritjet dhe sfidat e zbatimit të kësaj strategjie; së dyti, i ashtuquajtur "arsim i gjelbër" mbetet ende marginal në krahasim me projektet materiale dhe arsimore që kanë të bëjnë me Kosovën, me luftën e viteve 1998-99, kujtimet e saj, dhunën seksuale dhe shoqërinë pas konfliktit¹⁷; dhe së treti, kurrikula për arsimin e gjelbër - e cila është e detyrueshme prej klasës së tretë deri në klasën e pestë në shkolla fillore - mbetet fakultative dhe në diskrecion të drejtorit të shkollës në nivelin e shkollës së mesme dhe të shkollës së mesme të lartë. Lidhur me këtë, dy çështje të tjera dalin në plan të

parë: kurrikula e miratuar në shkolla fillore vërtet nuk i angazhon nxënësit në këtë temë, duke ofruar njohuri dhe informata që nxënësit mezi mund t'i mësojnë dhe zbatojnë në praktikë. Gjithashtu, një numër i madh i OSHC-ve lokale e kanë lehtësuar sistemin shkollor në rishikimin e mësimdhënies duke promovuar vetëm aktivitetet në klasë pa i zgjeruar mënyrat e të mësuarit dhe zbatimin e njohurive të fituara në praktikë.



Duke i angazhuar nxënësit në sport, ata e përjetojnë edhe natyrën – e cila duhet mbrojtur për t'i respektuar të drejtat tona. Ne kemi iniciuar aktivitete edukative në bashkëpunim me shkollat, ku deri më tani janë angazhuar më shumë se 500 nxënës.”

BARDHA UKA, DEMOKRACI PËRMES SPORTIT

Një shqetësim i madh është edhe mungesa e përgatitjes së mësimdhënësve me ekspertizë të konsiderueshme për çështjet mjedisore. Në nivel të shkollës së mesme, klasat dhe kurrikulat e tjera, si biologjia, përdoren për ta lidhur mjedisin me disa perspektiva socio-ekologjike.¹⁸ Megjithatë, zbatimi i së njëjtës kurrikulë ndryshon shumë: ndërkohë që disa shkolla dhe qendra arsimore rregullisht e përdorin kurrikulën e gjelbër. Megjithatë, pa shkathtësi profesionale të mësimdhënies, të tjerët dështojnë. Për sa i përket menaxhimit

17 Intervistë me Evelin Van der Kooi, Sustainable Living Kosovo, intervistë online, 28 shkurt 2022.

18 Intervistë me Vlora Kurbogaj dhe Viola Berishën, Respektoni të Drejtat Tona, intervistë online, 11 mars 2022.

të mbeturinave, në veçanti, organizata të ndryshme rinore janë angazhuar në mënyrë aktive në promovimin e aktiviteteve të ndryshme të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve për ta përmirësuar mendimin kritik të të rinjve. Porositë që duhet të barten dhe praktikatat që duhet të futen lidhen me çështjet e menaxhimit të mbeturinave dhe “çfarë ndodh me mbeturinat?”. Ndërsa shumica e trajnimeve dhe projekteve arsimore përqendrohen në “ndarjen e mbeturinave”, studentët, të rinjtë dhe qytetarët e thjeshtë nuk dinë mjaftueshëm për tërë procesin e riciklimit apo për parimet e ekonomisë qarkore. Mendimi kritik ndihmon në vizualizimin e mozaikut më të madh të kërcënimeve shëndetësore për shkak të keqmenaxhimit të mbeturinave.



“Shkollat janë vend për t’u vizituar dhe trajnuar njerëzit. Fushata ‘Më pak është më shumë’ u mendua për t’u treguar njerëzve si të jetojnë me më pak dhe më mirë. Trajnimi me nxënësit në shkollë ka qenë i orientuar për ta përcjellë tablonë e procesit të mbeturinave dhe ne e kemi theksuar veçanërisht potencialin e madh të riciklimit të duhur.”

EGZONA SHALA, ECOZ

Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional

ndërmjet sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve arsimore është portretizuar si mjet për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e biodiversitetit. Deri diku, ky bashkëpunim është arritur me sukses në nivel lokal. Nismat spontane janë përhapur shpejt dhe kanë shkuar përtej ndarjeve etnike dhe brezave. Po ashtu, komuna e Vushtrrisë ka filluar të bashkëpunojë me kompaninë “KRU Uniteti” për t’ia siguruar çdo shtëpie një kontejner pa pagesë, si dhe me të ashtuquajturat “Klubet e Gjelbra” ku nxënësit realizojnë projekte për riciklimin dhe ndarjen e mbeturinave (Connective Cities 2021). Praktika e “Klubeve të Gjelbra” është shtrirë edhe në zona të tjera të Kosovës nga OSHC-të e ndryshme. Në tri vitet e fundit, e veçanërisht gjatë pandemisë, ky bashkëpunim ndërmjet institucioneve, autoriteteve arsimore dhe sektorit të shoqërisë civile ka krijuar një nga praktikatat më të mira në Kosovë.¹⁹ Megjithatë, nisma të ngjashme duhet të pajisen me logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme, duke u mundësuar nxënëseta përjetojnë ndryshimin në praktikë dhe në mënyrë të qëndrueshme.²⁰

Një shembull tjetër interesant është edhe “Ekoshkolla”, e iniciuar nga Ec Ma Ndryshe në vitin 2018, ku nxënës dhe mësime ndryshe aplikojnë për grante me ide të përbashkëta për projekte në emër të shkollës. Në disa raste, ka pasur mundësi të rishikohen dhe shndërrohen ambientet e përbashkëta të shkollave në hapësira shumëfunktionale për aktivitete rekreative ose riciklim të gjësendeve (si kanaçe), dhe të ardhurat e mbledhura janë investuar në aktivitete për rinovimin e shkollës. Nisma ka lejuar rritjen

19 Intervistë me Merlina Beu Muçajn, PAMKOS - Shoqata për Mbrojtjen dhe Pastrimin e Mjedisit të Kosovës, intervistë online, 3 mars 2022.

20 Intervistë me Arben Nikën, Qendra për Edukimin dhe Zhvillimin e Mjedisit, intervistë online, 7 mars 2022.

e ndërgjegjësimit, ofrimin e njohurive të përditësuara për mësimdhënës, mbrojtjen e mjedisit dhe gjenerimin e fondeve të vogla për vetë institucionin arsimor.²¹

Duke u zhvendosur në një grupmoshë më të vjetër, disa të diplomuar në studimet e menaxhimit mjedisor – program ky që mësohet në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, - i janë bashkuar sektorit të shoqërisë civile si hulumtues dhe ekspertë të mjedisit.²² Por, siç theksohet nga të intervistuarit, mungesa e profesionalizmit të personelin mësimdhënës mbetet pengesë për mbulimin e nevojave për përcjelljen e një niveli më të lartë të njohurive dhe dijenive jo vetëm brenda shoqërisë civile, por posaçërisht në sektorin e arsimit. Nga njëra anë, OSHC-të janë parësore për edukimin e qytetarëve të zakonshëm, por, nga ana tjetër, vendosja e metodologjive të duhura në arsim, të bazuara në hulumtimin e duhur dhe mbledhjen e të dhënave, është me rëndësi të madhe në planin afatgjatë. Në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike është nikoqir i Departamentit të Termoteknikës dhe Energjisë së Ripërtëritshme, i cili u ofron studentëve vendorë praktikat dhe njohuritë më të fundit për çështjet kryesore mjedisore të Kosovës. Megjithatë, ndërkohë që njëfarë bashkëpunimi ndërmjet fakulteteve, studentëve të dalluar dhe aktorëve të shoqërisë civile zhvillohet në nivel lokal dhe personal, distanca ndërmjet këtyre të fundit dhe institucioneve zërthen një sërë çështjesh që e cenojnë të njëjtin bashkëpunim ndërmjet arsimit dhe shoqërisë civile. Shumica e ekspertëve dhe studiuesve nuk kryejnë në mënyrë adekuate studime të

detajuara dhe të hollësishme për shkak të mungesës së të dhënave në të gjitha nivelet. Nga ana tjetër, studentët nuk kanë informata dhe të dhëna zyrtare për të hulumtuar dhe për t'i avancuar njohuritë. Përafrimi i të dhënave dhe informatave gjithashtu e cenon reputacionin e Kosovës në nivel ndërkombëtar. Kur fakultetet marrin pjesë në analizat në natyrë, të dhënat e ofruara thjesht llogariten përafërsisht në rastin e burimeve të rinovueshme, sektorit të energjisë, si dhe menaxhimit të mbeturinave.²³

Është e qartë që dialogu ndërmjet universiteteve dhe institucioneve është gjithashtu shqetësim, posaçërisht për studentët. Përderisa qindra studentë të rinj në Kosovë marrin një nivel të lartë të dijeve dhe njohurive lidhur me mjedisin dhe çështjet e lidhura me të në vend e më gjerë, krijimi i bashkëpunimit për aftësim profesional dhe praktikë në sektorin e punësimit të tyre të mundshëm në të ardhmen pothuajse nuk ekziston. Kjo ka një ndikim të dyfishtë në të ardhmen e tyre. Së pari, mospasja e mundësive për të ndjekur ndonjë aktivitet praktik gjatë gjithë shkollimit i lë studentët pa ndonjë certifikatë të veçantë për t'u përdorur në tregun e punës që gjithnjë po ndryshon. Së dyti, kjo çështje i detyron shumë të rinj të diplomuar të largohen nga vendi për përvojë praktike në BE e më gjerë, ose të kërkojnë zhvillim të përhershëm profesional në ato vende. Thjesht, në rastin e parë, shumë të rinj mezi kthehen në shtëpi pasi kanë fituar aftësi që praktikisht nuk mund të përdoren në Kosovë për shkak të infrastrukturës së pazhvilluar në vend. Në rastin e dytë, ata nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të qëndrojnë atje.

21 Intervistë me Valon Xhibalin, Ec Ma Ndryshe, intervistë online, 9 mars 2022.

22 Intervistë me Urim Xhavarinën, Let's Do it Peja, Prishtinë, 15 mars 2022.

23 Intervistë me Prof. Xhevat Berishën dhe Prof. Bukurije Hoxhën, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Prishtinë, 14 mars 2022.



Drejt një sistem të gjelbër të virtytshëm dhe gjithëpërfshirës

Trajektorja aktuale lidhur me mbeturinat në Kosovë bie ndesh me parimet themelore të mbrojtjes dhe ruajtjes së habitateve natyrore. Në dy strategjitë e fundit për menaxhimin e mbeturinave, autoritetet kanë dhënë përgjigje politike bazuar në modelin e ekonomisë qarkore të prodhimit dhe konsumit, i cili për momentin mbetet në një fazë embrionale. Prandaj, ekziston nevoja për veprime të menjëhershme të orientuara drejt rritjes së vëmendjes së publikut, krijimit të partneriteteve dhe përpjekjeve me shumë palë për t'i ndryshuar zakonet, si dhe vendosjen e një qasjeje të integruar për menaxhimin e mbeturinave bazuar në parimet e reduktimit, ripërdorimit, riciklimit dhe asgjësimit.

Tani për tani, vetëm një pjesë e vogël e mbeturinave të grumbulluara riciklohet, shumica e të cilave bëhet në mënyra joformale. **Riciklimi mbetet sfidë e madhe** për institucionet qendrore dhe lokale, para së gjithash për shkak të **mungesës së infrastrukturës**. Nga 36 komuna në Kosovë, vetëm 7 prej tyre e kanë njëfarë

niveli të infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave në burim për amvisëri (AKMM 2022: 30). Ndërkohë, 25 komunave u mungojnë madje edhe planet pesëvjeçare për menaxhimin e mbeturinave lokale, të cilat pritet të mbështeten në parimet e ndarjes së mbeturinave në burim dhe në ekonominë qarkore. Raporti i fundit i AKMM-së thekson se numri i përgjithshëm i amvisërive të përfshira në praktikatat e riciklimit në Kosovë është i barabartë me 15.061 njësi, ose pothuajse 5% në nivel kombëtar (AKMM 2022: 30). Për më tepër, kjo nënvizon se një pjesë e madhe e komunave të Kosovës nuk mund ta raportojnë situatën aktuale në territorin e tyre përkatës lidhur me aktivitetet dhe praktikatat e riciklimit. Prandaj, është e pamundur të përgjithësohet në këtë fazë.

Deri më tani, donatorët e huaj kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë fushë. Ata janë përpjekur t'i nxisin praktikatat e riciklimit duke ofruar fonde, njohuri dhe shkathtësi teknike në bashkëpunim me aktorët vendorë. Megjithatë, praktikatat pilote të tentuara nuk kanë

qenë gjithmonë të suksesshme për sa i përket qëndrueshmërisë, ndonjëherë e kanë minuar besueshmërinë në sytë e komuniteteve lokale.²⁴ Prandaj, ndërhyrjet e ardhshme duhet të koordinohen mirë dhe të shpërndahen në tërë vendin, duke filluar me investime të qëndrueshme në infrastrukturën adekuatë të riciklimit, shkëmbimin e përvojës nga realitetet e shfaqura në vend dhe aktivitete të vazhdueshme arsimore formale dhe joformale. Në këtë drejtim, një alokim adekuat i fondeve konsiderohet thelbësor për krijimin e një modeli të prodhimit dhe konsumit, i cili synon ta zvogëlojë ndikimin edhe në mjedis, edhe në ekonominë lokale të mirëmbajtur keq.

Gjatë dy vjetëve të fundit janë krijuar disa ndërmarrje sociale të orientuara në ekonominë qarkore, si *Ndërmarrja Sociale dhe Riciklimi* (SEREC) në Pejë dhe *Kosovo Glass Recycling* (KGR) në Gjakovë. SEREC-i ka krijuar një zinxhir të qëndrueshëm të klasifikimit të shitjeve të mundshme në dyqan pas marrjes, riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve të tekstilit për t'u ridizajnuar para shitjes. Ky projekt sipërmarrës përfshin gjithashtu OSHC-të që ofrojnë dhe zbatojnë trajnime profesionale në shkolla dhe qendra arsimore. Po kështu, në Gjakovë, biznesi i suksesshëm familjar i KGR-së deri më tani i ka ricikluar 500 tonë qelq.²⁵ Në sajë të mirënjohjes dhe çmimit të dhënë nga programi Habitat i OKB-së, KGR-ja ka vazhduar të investojë në blerjen e makinerive të reja për riciklimin e qelqit dhe zbatimin e "misionit" të saj.

Perspektiva e një Kosove më të gjelbër mbështetet në **kombinimin e tre komponentëve strukturorë** që kontribuojnë në një ndryshim pozitiv dhe qëndrueshmëri në të ardhmen. Ata konsiderohen përforcues reciprokë dhe mund të kenë ndikim në fusha të tjera të politikave. Siç ilustron në figurën 5, komponenti i parë ku duhet përqendruar është **mjedisi**, i cili u bën thirrje autoriteteve që ta përfshijnë mbrojtjen e mjedisit në prioritetet kryesore të agjendës aktuale politike. Kjo përfshirje transversale do të ndodhë fillimisht përmes integritimit të perspektivave të gjelbra si në kornizën ligjore, ashtu edhe në atë politike, duke i mbështetur kështu politikat e gjelbra dhe proceset vendimmarrëse në të gjitha nivelet. Së fundi, pjesëmarrja e shumë palëve mund ta përmirësojë, angazhojë dhe mbështesë arsimin, dhe të nxisë aktivitete edukative e ndërjegjësuere për tema që lidhen me mjedisin. Të gjitha këto do ta forcojnë **sundimin e ligjit**, e kjo do të kishte ndikim të madh në ruajtjen dhe promovimin e një vendi më të gjelbër. Prandaj, mbështetja dhe përsëritja e praktikave të mira lokale do të ishte gjithashtu domethënëse dhe në përputhje me sundimin e ligjit, duke treguar nevojën për ta inkurajuar dhe stimuluar një pajtueshmëri më të gjerë dhe më të madhe qytetare me normat në fuqi. Së fundi, këta dy komponentë do të hyjnë në punë për të promovuar **alternativa** më koherente në terren, duke i zgjeruar veprimet e ekonomisë qarkore në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

24 Intervistë me Arben Nikën, Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit, 7 mars 2022.

25 Intervistë me Martin Berishën, Kosovo Glass Recycling, Prishtinë, 17 mars 2022.




FIGURA 5

Një qasje vizuale ndaj tre komponentëve strukturorë që kontribuojnë në ndryshime pozitive dhe qëndrueshmëri në të ardhmen në Kosovë

Konkluzione dhe rekomandime

Përkundër kufizimeve institucionale për zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave në nivel komunal në Kosovë, disa perspektiva bazë tregojnë për një nivel të lartë të aftësisë së qytetarëve për t'i trajtuar çështjet kyçe në fjalë, si dhe një ndërgjegjësim për krizën ekologjike te brezi i ri. Shumica e ekspertëve, aktivistëve dhe ambientalistëve të intervistuar kanë konfirmuar tendenca të tilla në nivelin lokal. Përveç kësaj, ne zbuluam se edukatorët dhe praktikuesit

janë gjithashtu të vetëdijshëm për nevojën për t'i zgjeruar njohuritë e tyre, dhe tregojnë një gatishmëri për t'i zbatuar paradigmat në ndryshim e sipër të qëndrueshmërisë mjedisore duke bashkëpunuar me autoritetet lokale dhe kombëtare. Një tregues i përbashkët i të intervistuarve vë në pah rolin e arsimit si mjet vendimtar për të mbrojtur mjedisin në përgjithësi dhe për të formuar një qasje qytetare ndaj edukimit, çka bashkon brezat dhe e nxit bashkëpunimin në planin afatgjatë.

Rekomandime për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit:

- ☉ Të hartohen dokumentet dhe procedurat e politikave të nevojshme për kategorizimin dhe menaxhimin e të gjitha llojeve të mbeturinave;
- ☉ Të zhvillohen dhe mbështeten procedurat e politikëbërjes që marrin parasysh alternativa të reja dhe praktika të mira që rrjedhin drejtpërdrejt nga komunitetet lokale dhe njohuritë e tyre;
- ☉ Të krijohet infrastruktura e përshtatshme e cila lejon reduktimin, ripërdorimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave;
- ☉ Të arrihet një gjuhë të përbashkët dhe të koordinohen veprimet ndërmjet qytetarëve, institucioneve lokale e qendrore dhe operatorëve të kontraktuar të ngarkuar me grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave;
- ☉ Të aplikohet një monitorim i vazhdueshëm e i pavarur i grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave komunale në mënyrë që të ushtrohet presion proaktiv në aktorët në terren;
- ☉ Të konsultohen dhe angazhohen komunitetet lokale për t'i adresuar nevojat e tyre lokale rreth çështjeve mjedisore;
- ☉ Të miratohen skema të subvencionimit për operatorët e biznesit në fushën e riciklimit në mënyrë që të kontribuohet në një kthesë drejt shfaqjes së ndërmarrjeve të reja sociale.
- ☉ Të krijohet një zinxhiri funksional dhe operues që lidh qytetarët (si prodhues të mbeturinave), kompanitë private të grumbullimit dhe komunitetin e biznesit të angazhuar në aktivitetet e riciklimit.

Rekomandime për edukimin e gjelbër, ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin ndërmjet agjencive:

- ☉ Të përditësohet kurrikula ekzistuese për edukimin mjedisor në shkolla të mesme dhe të bëhen të detyrueshme;
- ☉ Të investohet në programe të mësimnxënies dhe mësimdhënies rreth çështjeve mjedisore për mësimdhënës të shkollave;
- ☉ Të stimulohet qasja ndërdisiplinore si një mënyrë mësimdhënieje dhe mësimnxënies për mjedisin dhe menaxhim të mbeturinave në veçanti, dhe ndikim në shoqëri nëpërmjet promovimit të praktikave të qëndrueshme në nivel lokal;
- ☉ Të promovohen dhe mbështeten aktivitete jashtëshkollore dhe në natyrë , si vizita studimore rreth zonave të gjelbra në qytete pranë, zona të gjelbra publike, orë laboratorit në shkolla etj.;
- ☉ Të përmirësohet krijimi i kopshteve të vogla me perime dhe lule të menaxhuara nga shkollat (me ndihmën e prindërve) me qëllim që brezat e rinj të afrohen me natyrën, dhe të shpjegohen proceset e riciklimit bashkë me agjendën e gjelbër;
- ☉ Të krijohen skema të riciklimit pranë institucioneve arsimore, si mjete joformale për edukimin dhe ndërgjegjësimin e brezave të rinj;
- ☉ Të përmirësohet koordinimi ndërinstitutional për agjendën e gjelbër dhe të krijohet platforma e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve qendrore/lokale me aktivistë dhe OSHC që merren me çështje të gjelbra;
- ☉ Të rritet bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve komunale, kompanive të përfshira në menaxhimin e mbeturinave dhe sektorit privat aktiv në nivel lokal me OSHC-të lokale, institucionet arsimore dhe komunitetet e banorëve për të ndërmarrë fushata pastrimi, aktivitete për ngritjen e vetëdijesimit, si netët e filmave, festivale, panairët e gjelbra, tregjet artizanale dhe të sendeve të përdorura etj.;
- ☉ Të forcohet bashkëpunimi me gazetarët dhe punonjësit e mediave dhe të përmirësohen njohuritë e tyre për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit.

Lista e intervistave

- 🕒 Intervistë me Evelin Van der Kooi, Sustainable Living Kosovo, intervistë online, 28 shkurt 2022.
- 🕒 Intervistë me Egzona Shalën, Youth Ecological and Security Zone-EcoZ, Prishtinë, intervistë online 2 mars 2022; Intervistë vijuese personale në Prishtinë, më 16 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Merlina Beu Muçajn, PAMKOS - Shoqata për Mbrojtjen dhe Pastrimin e Mjedisit të Kosovës, intervistë online, 3 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Arben Nikën, Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit, intervistë online, 7 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Valon Xhibalin, Ec Ma Ndryshe, intervistë online, 9 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Afrim Berishën, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, intervistë online, 10 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Helena Poučki, GAIA Kosovo, intervistë online, 11 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Vlera Kurbogajn dhe Viola Berishën, Respektoni të Drejtat Tona, intervistë online, 11 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Prof. Xhevat Berishën dhe Prof. Bukurije Hoxhën, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Prishtinë, 14 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Bardha Ukën, Demokraci përmes Sportit, Prishtinë, 14 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Urim Xhavarinën, Let's Do it Peja, Prishtinë, 15 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Martin Berishën, Kosovo Glass Recycling, Prishtinë, intervistë online, 17 mars 2022.
- 🕒 Intervistë me Arta Haxhixhemajlin, Qendra për Analizë të Sigurisë dhe Parandalim (CBAP), Prishtinë, 17 mars 2022.

Referencat

Connective Cities (2021) Menaxhimi i mbeturinave në Vushtrri, Kosovë. Një sistem efektiv edhe gjatë pandemisë, Berlin, Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. 30.05.2021. <https://www.connective-cities.net/en/news/waste-management-in-vushtrri-kosovo>

Koalicioni Të Drejta të Barabarta për të Gjithë (2019) Mbledhja joformale e mbeturinave dhe riciklimi. Qasur më 09.06.2022. https://www.ecmikosovo.org/uploads/Informal_Waste_ALB.pdf

Komisioni Evropian (2020) Kosovë* 2020 Raport, SWD (2020) 356 final, Bruksel. Qasur më 09.06.2022. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/kosovo_report_2020.pdf

Komisioni Evropian (2021) Kosovë* 2021 Raport, SWD (2021) 292 final/2, Bruksel. Qasur më 09.06.2022. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en

Agjencia Evropiane e Mjedisit (2021) Menaxhimi i mbeturinave komunale në vendet e Ballkanit Perëndimor – Profili i Shtetit, Kosova*, nëntor. Qasur më 18.07.2022. <https://www.eea.europa.eu/themes/waste/waste-management/municipal-waste-management-country/kosovo-municipal-waste-factsheet-2021/view>

Hofhuis, Paul (2021) Agjenda e Gjellbër: Sigurimi i hapësirë politike për frymëmarrje për qytetarët e Ballkanit Perëndimor? Clingendael: Instituti Holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Qasur më 15.01.2022. https://www.clingendael.org/sites/default/files/2021-07/PB_The_Green_Agenda_3thproof.pdf

Kabashi, Fjollë (2021) Gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë 2021, WtERT Gjermani. Qasur më 09.06.2022. <https://www.wtert.net/paper/4412/Current-state-of-Waste-Management-in-Kosovo-2021.html>

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (2022) Raport i Menaxhimit të Mbeturinave Komunale në Kosovë, Viti Raportues 2020. Qasur më 09.06.2022. <https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Dokumente%202022/Raporti%20per%20menaxhimin%20e%20mbeturinave%20komunale%202020.pdf>

Zyra e Kosovës (2016) Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, Prishtinë. Qasur më 09.06.2022. https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

Republika e Kosovës (2021) Raporti i Auditimit të Performancës. Mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale, Prishtinë. Qasur më 09.06.2022. <https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/Mbledhja-trajtimi-dhe-asgjesimi-i-mbeturinave-komerciale.pdf>

Srbnovski, Mile, Çarkaj, Leonora dhe Ismaili, Murtezan (2020) Botëkuptimi mjedisor: Një rast studimor i të rinjve nga Kosova, Rishikim i SEEU, 14, (2): 185-195.

Për autorët

Francesco Trupia, PhD, është hulumtues post-doktorant pranë Qendrës për Ekselencë IMSErt pranë Universitetin Nicolaus Copernicus në Torun (Poloni), ku kryesisht kontribuon në Laboratorin për Studimin e Memories Kolektive të Evropës Post-Komuniste. Së fundi, ai ka punuar gjithashty pranë Qendrës për Analiza të Sigurisë dhe Parandalim në Republikën Çeke dhe për Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur. Në të kaluarën ka kontribuar në Qendrën Burimore për Hulumtim në Kaukaz (CRRC) në Armeni dhe në Institutin për Çështje Strategjike Islamike (IISA) në Britaninë e Madhe. Pjesa kryesore e hulumtimeve të tij fokusohet tek politika e identitetit dhe përfshirja e grupeve minoritare në Evropën Juglindore dhe Kaukazin Jugor. Ai ka ekspertizë për shtetet e Armenisë, Bullgarisë, Kosovës dhe Ukrainës.

Gentiola Madhi është hulumtuese dhe analiste politikash rezidente në Itali. Që nga viti 2018, ajo kontribuon në mënyrë të rregullt pranë Osservatori Balcani & Caucaso Transeuropa. Më parë, Gentiola ka punuar si menaxhere projekti në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë dhe si zyrtare programi pranë Helvetas Swiss Intercooperation në Tiranë. Ajo është alumne e Kosovo Research and Analysis Fellowship (gjenerata 2019). Gentiola ka qenë bursiste e Think Visegrad pranë EUROPEUM Instituti për Politika Evropiane në Republikën Çeke në vitin 2018. Ajo ka përfunduar studimet pranë Kolegjit të Evropës (Bruges), Universitetit të Firences dhe Kolegjit Evropian të Parmës (Itali). Interesat e saj hulumtuese përfshijnë bashkëpunimin rajonal, mediat dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE.

